



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCAVE
DHE EKONOMISË
NR. 23590 DATË 17.12.2020

MINISTRIA E
INFRASTRUKTURËS DHE
ENERGJISË
NR. 8104 DATË 21.12.2020

URDHËR I PËRBASHKËT

Nr. 304 datë 17.12.2020

“PËR

MIRATIMIN E PLANIT TË MASAVE TË REDUKTIMIT TË DETYRIMEVE TË
PRAPAMBETURA NË SEKTORIN E ENERGJISË ELEKTRIKE”

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, bazuar në "Memorandumin e Mirëkuptimit për Huanë për Politikën e Reformës (PBL): "Mbështetja e reformës në sektorin e energjisë në Shqipëri" ndërmjet Ministrisë të Financave dhe Ekonomisë (MoFE), Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) dhe KfW dhe Agence Française de Développement (AFD). nënshkruar më datë 14.12.2018, bazuar në VKM nr. 253, datë 24.4.2019, "Për miratimin e planit të konsolidimit financiar të sektorit publik elektroenergjetik" dhe VKM nr. 824 datë 18.12.2019 "Për miratimin e Strategjisë Sektoriale të Menaxhimit të Financave Publike" 2019-2022.

URDHËROJMË

1. Miratimin e planit të masave të reduktimit të detyrimeve të prapambetura në sektorin e energjisë elektrike sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij urdhri
2. Ngarkohen institucionet dhe njësitë e përcaktuara në planin e masave për zbatimin e aktiviteteve të këtij plani sipas fushës së përgjegjësisë.
3. Ngarkohen për ndjekjen e zbatimit të këtij urdhri strukturat përgjegjëse për energjinë dhe ujin në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe strukturat përgjegjëse për monitorimin e detyrimeve të prapambetura në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë
4. Ky Urdhër hyn në fuqi menjëherë

MINISTRI I FINANCAVE DHE
EKONOMISË

Amila DENAJ

MINISTRI I
INFRASTRUKTURËS DHE
ENERGJISË

Bëlmir BALLUKU

17 Dhjetor 2020

PLANI I MASAVE TË REDUKTIMIT TË DETYRIMEVE TË PRAPAMBETURA NË SEKTORIN E ENERGJISË ELEKTRIKE

Përmbledhje

Trajtimi i detyrimeve të prapambetura në sektorin e energjisë ka qenë një proces sfidues për shkak të nivelit të lartë të detyrimeve të trashëguara dhe akumulimit të detyrimeve të reja. Procesi i konsolidimit të detyrimeve të mbartura është menaxhuar përmes një marrëveshje rristurimi afatgjatë mes kompanive. Si rezultat i zbatimit të reformës në sektor, janë akumuluar dhe disa detyrime të reja mes kompanive. Detyrimet e prapambetura nga njësitë e tjera publike, veçanërisht ndërmarrjet e ujit, mbeten problem për shkak të mekanizmit të dobët të ekzekutimit të pagesave. Për rrjedhojë, procesi i reduktimit të detyrimeve të prapambetura dhe parashikueshmëria e të ardhurave janë penguar, duke krijuar vështirësi për likuiditetin dhe planet e investimit në sektor. Marrja e masave për të ndaluar akumulimin e borxheve të reja është një parakusht i rëndësishëm për reduktimin e përgjithshëm të detyrimeve prapambetura në sektor. Ky dokument propozon një plan veprimi për të parandaluar borxhet e reja ndërmjet kompanive të energjisë elektrike dhe për të forcuar disiplinën e pagesave nga palët e treta. Pas disiplinimit të pagesave korrente, procesi i reduktimit të detyrimeve të prapambetura sigurohet nëpërmjet marrëveshjeve të rristurimit të borxheve mes kompanive, dhe ku është e mundur, netimin e detyrimeve të ndërsjella për të përshpejtuar procesin e konsolidimit.

Përmbajtja

1. Hyrje 2
2. Ecuria e detyrimeve të prapambetura në tre viteve të kaluara 3
- 3 Statusi i marrëveshjeve të shlyerjes të detyrimeve të prapambetura 4
 - 3.1 OShEE-KESh 4
 - 3.2 OShEE-OST 4
 - 3.3 OST-KESh 5
 - 3.4 Detyrimet e prapambetura me palët e treta 5
4. Plan i veprimit për pastrimin e detyrimeve të prapambetura 5
 - 4.1 Detyrimet e prapambetura të mbartura OShEE- KESh 7
 - 4.2 Detyrimet e prapambetura ndërmjet OShEE-OST 7
 - 4.3 Shmangia e krijimit të detyrimeve të prapambetura të reja midis OShEE dhe KESh 8
 - 4.4 Shmangia e detyrimeve ndërmjet OShEE-OST-KESh për shërbimet e balancimit 8
 - 4.5 Detyrimet e prapambetura nga njësitë e sektorit publik 9

Ndërmarrjet e ujësjellësit 9

Detyrimet nga institucionet buxhetore 10

Detyrimet tatimore 11
5. Rezultatet e pritura të planit të veprimit 11

1. Hyrje

Reforma e sektorit të energjisë synon përmirësimin e cilësisë së furnizimit me energji elektrike dhe arritjen e qëndrueshmërisë financiare të sektorit. Qëndrueshmëria financiare varet nga shumë faktorë, por kryerja në kohë e pagesave të përdoruesve fundor, qofshin ata privatë apo publikë, dhe kompanive është thelbësore. Kolapsi i sektorit të energjisë elektrike në vitin 2013 çoi në akumulimin e më shumë se gjysmë miliard Euro detyrimesh të prapambetura ndërmjet kompanive që u financua në pjesën më të madhe nga linjat e shtrenjta të kredive të mara nga KESH dhe nga buxheti i shtetit.

Që prej vitit 2014 situata financiare në sektor ka ardhur duke u përmirësuar. Humbjet e shpërndarjes u ulën nga 43% në 2013 në 22% pas një fushate masive për zvogëlimin e vjedhjes të energjisë elektrike dhe për përmirësimin e mbledhjes të të ardhurave. Në vitin 2015 tarifat e reja të aplikuara për të pasqyruar më mirë kostot e furnizimit, ndihmuan në zvogëlimin e mëtejshëm të hendekut financiar.

Përmirësimi i situatës financiare mundësoi procesin e ristrukturimit të stokut të borxheve të akumuluar midis kompanive të energjisë. Fillimisht ristrukturimi u bazua në një rregull pagese 105% të faturave korrente midis OSHEE me KESH dhe OSHEE me OST.¹ Ky rregull u shndërrua në një marrëveshje dypalëshe midis OSHEE dhe KESH në 2018. Përparim ka pasur dhe për zvogëlimin e detyrimeve të prapambetura nga kompanitë e tjera shtetërore në veçanti ndërmarrjet e ujësjellësit përmes një mekanizmi netimi në 2014. Detyrimet e prapambetura të kompanive (OSHEE dhe KESH) ndaj tatimeve janë ulur rregullisht çdo vit, ndërkohë që të gjitha kompanitë e energjisë elektrike kanë përmbushur të gjitha detyrimet korrente të taksave.

Situata financiare e sektorit të energjisë është padyshim më mirë se disa vite më parë. Për të thelluar këtë progres duhen ripërtëritë përpjekjet për kryerjen në kohë të pagesave mes palëve, që do të ndihmojë menaxhimin e likuiditetit të sektorit dhe në uljen e detyrimeve të prapambetura ndërmjet kompanive me kalimin e kohës.

Plani i veprimit në këtë dokument synon forcimin e mëtejshëm të procesit të nisur të pastrimit të detyrimeve të prapambetura dhe të parandalojë krijimin e borxheve të reja në sektorin e energjisë elektrike duke synuar zbatimin e masave për të përmirësuar disiplinën e pagesave.

Ky dokument është përgatitur në kuadër të asistencës teknike të ofruar për Qeverinë e Shqipërisë për zbatimin e Reformës së Sektorit të Energjisë bazuar në "Memorandumin e Mirëkuptimit për Huanë për Politikën e Reformës (PBL): "Mbështetja e reformës në sektorin e energjisë në Shqipëri" ndërmjet Ministrisë të Financave dhe Ekonomisë (MoFE), Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) dhe KfW dhe Agence Française de Développement (AFD). Memorandumi i Mirëkuptimit parashikon zbatimin e disa Elementeve të Reformës (PRE) që synojnë përmirësimin e qëndrueshmërisë financiare të sektorit të energjisë dhe zhvillimin e parimeve të tregut në segmentet konkurruese të furnizimit me energji elektrike.² Ky dokument mbulon Elementin e parë të reformës (PRE1) me titull: Marrëveshje për detyrimet e prapambetura dhe përmirësimin e disiplinës të pagesave të njësive publike. PRE1 synon një rezolutë për reduktimin e detyrimeve të prapambetura midis njësive të ndryshme publike.

¹ Sipas Projektit të Rimëkëmbjes të Sektorit të Energjisë të Bankës Botërore (Kredi Nr. 8429-AL), Seksioni IV.A.1. (A) (iv): "... OSHEE do të hapë një llogari të Ruajtjes së të Ardhurave në një institucion financiar ... [në masën] 105% e faturës mujore të blerjes së energjisë në KESH dhe 105% të faturës mujore të tarifave të transmetimit për OST deri në momentin kur të amortizohen plotësisht detyrimet e prapambetura të secilës njësi zbatuese të projektit "

² Një Zyrë e Zbatimit të Reformës (RIO) është themeluar si pjesë e këtij operacioni për të mbështetur Qeverinë e Shqipërisë në zbatimin e masave të reformës së politikave. Ky dokument është pjesë e një serie shënimesh të përgatitura nga RIO për të ndihmuar autoritetet shqiptare për të arritur një përfundim të kënaqshëm të të gjithë PRE-ve. Propozon një Plan Veprimi për zbatimin e Elementit 1 të Reformës së Politikës i cili kërkon një rezolutë për detyrimet e prapambetura dhe përmirësimin e disiplinës të pagesave

Ky dokument është organizuar si më poshtë. Seksioni 2 përshkruan sesi kanë evoluar detyrimet e prapambetura në tre vitet e fundit . Seksioni 3 analizon gjendjen aktuale të detyrimeve të prapambetura mes kompanive të energjisë elektrike dhe të palëve të treta . Seksioni 4 paraqet një plan veprimi për kontrollin dhe uljen e detyrimeve të prapambetura në sektor . Seksioni i fundit 5 përmbledh rezultatet e pritura nëse plani i veprimit zbatohet sipas parashikimit.

2. Ecuria e detyrimeve të prapambetura në tre vitet e kaluara

Që prej vitit 2018 përpjekjet për zvogëlimin e humbjeve në shpërndarje kanë qenë më sfiduese pasi progresi i mëtejshëm varet kryesisht nga investimet e reja, dhe me pak nga përmirësimi i mbledhjes të të ardhurave. Kushtet e pafavorshme të motit si në vitin 2017, vune në vështirësi kryerjen e pagesave në kohë midis kompanive në sektor. Mbështetja buxhetore nga qeveria ka qenë e nevojshme veçanërisht gjatë viteve të vështira kur kërkesat për import kanë qenë te larta.

Miratimi i modelit të ri të tregut, përfshirë këtu de-rregullimin (PRE4), rregullat e reja të balancimit dhe futja e operatorëve të rinj të energjisë së rinovueshme (PRE7) , ka shtuar presionin financiar mbi kompanitë e energjisë elektrike që duhet të menaxhohet të paktën gjatë kësaj faze tranzitore të reformës.

Edhe prej vështirësive të mësipërme, ecuria e detyrimeve të prapambetura në tre vitet e fundit ka qenë e luhatshme (Tabela 1). Stoku i papaguar midis OSHEE-KESH dhe OSHEE-OST është ulur përkatësisht me [1.8 miliardë] dhe 1.3 miliardë lekë. Ndërkohë, janë krijuar rishtazi detyrime të reja si rezultat i kontratave për përmbushjen e detyrimit të shërbimit publik me energji elektrike (KESH ndaj OSHEE) dhe shërbimeve të balancimit dhe ribalancimit (OSHEE ndaj OST-OST ndaj KESH). Kërkesa e lartë për import gjatë vitit 2018 çoi në akumulimin e detyrimeve të prapambetura midis OSHEE dhe KESH prej 1.8 miliardë dhe 0.9 miliardë lekë respektivisht në vitin 2018 dhe në vitin 2019 (në total 4 miliardë Lekë duke përfshirë dhe kamatë-vonesat). Prej këtyre detyrimeve "të reja" stoku i detyrimeve të prapambetura brenda sektorit nuk ka pasur përmirësim.

Tabela 1: Situata e borxheve (fundviti, miliardë Lekë)

2017							2018						
	KESH	OST	OSHEE	MFE	Tax	Total		KESH	OST	OSHEE	MFE	Tax	Total
KESH ndaj:		0.07	-	8.3 ⁽¹⁾			KESH to:		0.07	-	10.4	2.0	
OST:	1.0		-	3.8 ⁽²⁾			OST to:	4.4		0.34	7.4	=	
OSHEE:	50.1	9.1		3.6 ⁽²⁾			OSHEE to:	52.4	13.0		3.8	6.36	
Water U.			10.8				Water U.			13.2			
Budget I.			2.7				Budget I.			3.2			
Total							Total	56.8					
2019							2020 (latest)						
	KESH	OST	OSHEE	MFE	Tax	Total		KESH	OST	OSHEE	MFE	Tax	Total
KESH to:		0.08	5.1	12.7	1.8		KESH to:		0.08	6.4	14.9	0.76	
OST to:	4.2		0.8	9.7	=		OST to:	4.4		0.81	11.1	=	
OSHEE to:	53.3	13.8		4.2	6.32		OSHEE to:	52.5	14.4		4.5	4.9	
Water U.			15.9				to:						
Budget I.			3.7				o/w - FShU		0.46				
Total							- FTL		1.1				
							Water U.			17			
							Budget I.			3.8 ⁽³⁾			
							Total						

☑ marrëveshje dypalëshe; ☒ pa marrëveshje; (1) neto ndaj kësteve të (pa)transferuara të kredive të njohura nga OST dhe OSHEE; (2) përfshirë këstet e kredive të njohura si pjesë e procesit të ndarjes nga KESH. KESH transferon automatikisht këto këste në MFE me të njëjtën shumë të paguar nga OST dhe OSHEE. (3) subjekt akt-rakordimesh mes palëve

Një kategori e detyrimeve të prapambetura që është përkeqësuar lidhet me faturën e energjisë elektrike të ndërmarrjeve të ujit. Reforma e vonuar e sektorit të ujit dhe mekanizmi i dobët i ekzekutimit të pagesave të energjisë elektrike çuan në ri-akumulimin e detyrimeve të prapambetura sa niveli i fshirë në fillim të reformës (netuar në 2014). Sektori i ujit akumulon mesatarisht 1.5 miliardë Lekë detyrime çdo vit që pothuajse dyfishohen nga kamatëvonesat. Disa nga marrëveshjet dypalëshe midis OSHEE dhe ndërmarrjeve të ujit nuk kanë qenë shumë efektive në zgjidhjen e problemit.


Sa i përket kategorive të tjera të borxheve, situata ka qenë më pak shqetësuese. Në veçanti detyrimet vjetore ndaj tatimeve janë paguar rregullisht, ndërsa stoku i detyrimeve të vjetra ka ardhur në ulje.

3. Statusi i marrëveshjeve të shlyerjes të detyrimeve të prapambetura

3.1 OSHEE-KESH

Midis OSHEE dhe KESH detyrimi i papaguar, që nga zgjidhja e çështjes me CEZ, prej 51.4 miliardë lekë (Figura 1.a) është ristrukturuar në një marrëveshje dypalëshe të nënshkruar në 2018. Ajo parashikon pagesa këstesh të shtrira në 29 vjet. Që nga nënshkrimi i marrëveshjes (2018) deri tani janë bërë tre pagesa këstesh kanë ndodhur prej 2.8 miliardë Lekë duke e ulur detyrimin e prapambetur në 48.6 miliardë lekë (fund 2020).

Figura 1: Statusi i detyrimeve të prapambetura



Ndërkohë është krijuar një detyrim shtesë [neto] prej [4.1] miliardë Lekë duke çuar nivelin e detyrimeve të prapambetura të OSHEE ndaj KESH në [53.4] miliardë lekë. Këto janë kryesisht mos përmbushje pagesash për energjinë elektrike të shitur në vitet 2018 dhe 2019, përfshirë dhe 2 miliardë lekë kamatë-vonesa. Këto detyrime janë njohur nga të dy kompanitë.

Nga ana tjetër, KESH ka një detyrim ndaj OSHEE prej 6.3 miliardë lekësh si pasojë e mos përmbushjes të kontratës në kuadër të detyrimit të shërbimit publik, në 2019 (5.1bn) dhe në 2020

(1.3bn), e njohur nga të dy kompanitë.

3.2 OSHEE-OST

Deri në fund të vitit 2017, detyrimet e prapambetura ndaj OST e 9.1 miliardë lekë prej të cilave 8.5bn lekë e faturave të papaguara transmetimit. Që nga viti 2018 OSHEE ka paguar të gjitha shumatat aktuale të faturave të tarifave të transmetimit. OSHEE ka paguar një pjesë të detyrimeve të prapambetura në bazë të rregullit të 105% por jo rregullisht.

Ndërkohë, detyrimet e OSHEE ndaj OST janë rritur për shkak të disbalancave. OSHEE ka dy detyrime ndaj OST, një prej 2.79 miliardë lekë (deri në fund të vitit 2019) të njohur nga të dy kompanitë dhe një tjetër prej 2.4 miliardë lekësh pas një vendimi të ERE i cili është kundërshtuar në gjykatë nga OSHEE.

3.3 OST-KESH

OST ka transferuar pjesën më të madhe të faturave të papaguara nga OShEE për disbalancat të KESH në vlerë prej 4.4 miliardë lekë (Figura 1.e) . [Kjo vlerë është e njohur nga të dy kompanitë.]

3.4 Detyrimet e prapambetura me palët e treta

Deri në 2020 ndërmarrjet e ujësjellësit kanë krijuar detyrime të reja ndaj OSHEE/FShU prej 17 miliardë lekësh, 9 miliardë nga të cilat janë kamatë vonesa. Pavarësisht diferencave në vlera midis asaj të raportuar nga OSHEE dhe të dhënave të raportuara nga ndërmarrjet e ujit (nëpërmjet AKUM), prirja në rritje e detyrimeve konfirmohet nga palët. OSHEE/FShU ka nënshkruar marrëveshje me disa nga ndërmarrjet e ujit për ristrukturimin e detyrimeve, por pak kanë qene efektive deri me sot. Për OSHEE/FShU rakordimi dhe ristrukturimi i borxheve të vjetra me ndërmarrjet e ujit është një çështje që duhet zgjidhur. Por më rëndësi se ristrukturimi i borxheve të vjetra ka përmbushja e pagesave korrente nga ndërmarrjet.

Sa i përket institucioneve buxhetore, shumica e detyrimit të papaguar është 5 miliardë lekë, 3 miliardë prej të cilave principal. Pësia e detyrimeve vjetore të akumuluar nga institucionet buxhetore mund të mos jete aq e madhe për OSHEE në krahasim me kategoritë e tjera të detyrimeve të papaguara. Në çdo rast, ky është një fenomen që duhet shmangur sidomos në kuadër të përpjekjeve për përmirësimin e sjelljes së konsumatorëve familjar ndaj pagesës së energjisë.

Borxhet afatgjatë të OST dhe OSHEE janë hua nga donatore (koncesionare) të nënshkruara nga KESH dhe transferuar tek OST/OSHEE pas procesit të ndarjes në 2004 dhe nën-hua (po nga donatorë) nga MFE të OST . Shlyerja e plotë e kësteve që prej vitit 2017 ka qenë sfiduese për të gjitha kompanitë, përfshi dhe detyrimet e vetë KESH³. Shumat që i detyrohen kompanitë MFE ndaj këtyre kredive është dyfishuar nga 2017 në 2020 duke arritur mbi 30 miliardë lekë. Me gjendjen aktuale të likuiditetit vjetor të kompanive lind nevoja e ristrukturimit të borxheve afatgjatë bazuar në rregulla të qarta korrektimi në rast se vonesat e ripagesave përsëriten.

4. Plani i veprimit për pastrimin e detyrimeve të prapambetura

Ky plan veprimi synon të parandalojë krijimin e detyrimeve të reja të prapambetura ndërmjet kompanive të energjisë elektrike në të njëjtën kohë që siguron një reduktim të qëndrueshëm të stokut të detyrimeve të prapambetura të akumuluar deri më sot ndërmjet kompanive.

Plani veprimit gjithashtu synon zbatimin e masave disiplinore për institucionet buxhetore dhe ndërmarrjet e ujit për të mos shmangur pagesën e faturave të energjisë elektrike. Për ndërmarrjet e ujit është propozuar një qasje graduale duke i dhënë fillimisht përparësi zbatimit rigoroz të pagesave për ato ndërmarrje që e kanë aktualisht aftësinë për të paguar. Me përmirësimin e aftësisë paguese të ndërmarrjeve të tjera në kuadër të përsheptimit të reformës në sektorin e ujit grupit i parë do të zgjerohet me të gjitha ndërmarrjet. Gjithashtu, detyrimet e prapambetura do të minimizohen duke i përfshire në treguesit e performacës të kompanive dhe kushtëzimin e subvencioneve buxhetore.

Për të përsheptuar uljen e stokut të detyrimeve të prapambetura do të aplikohen dhe mekanizma netimi të ngjashme me atë të aplikuar në vitin 2014, të paraprirë me disiplinimin e pagesave korrente për të shmangur riakumulimin e detyrimeve të prapambetura në të ardhmen, veçanërisht për ndërmarrjet e ujësjellësit.

Një përmbledhje e planit të veprimit paraqitet në Tabelën 2.

Tabela 2 : Plani i veprimit për trajtimin e detyrimeve të prapambetura në sektorin e energjisë elektrike

³ KESH përcjell automatikisht ripagesat e marra nga OST dhe OSHEE tek MFE.

Përshkrimi	Masat	Afati
1. Detyrimet e prapambetura ndërmjet ndërmarrjeve të sektorit të energjisë elektrike		
1.1 Stoku i detyrimeve të prapambetura 'të vjetra'		
1.1.1 OShEE-KESH	Këstet e parashikuar në marrëveshjes e nënshkruar (06.04.2018) (dhe të rishikuar) paguhen në kohë sipas planit të shlyerjes.	2021
1.1.2 OShEE-OST	Nënshkrimi i një marrëveshje të re mbi detyrimet e prapambetura duke shndërruar rregullin prej 105% në një plan të rregullt këstesh.	2020Q4
1.2 Detyrime të prapambetura 'të reja'		
1.2.1 OShEE / FSHU - KESH	(i) Rishikimi i kontratës FSHU-KESH në kuadër të detyrimit të shërbimit publik për të shmangur rigjenerimin e detyrimeve të reja (ii) Përfshirja e detyrimeve të krijuara deri më sot nga kontrata OShEE/FSHU-KESH për shërbimin publik si pjesë e rishikimit të marrëveshjes të datës 06.04.2018, (1.1.1)	2020Q4
1.2.2 OShEE-OST	(i) Pagesat për disbalancat nga 2020 e tutje kryhen në kohë (ii) Përfshirja e detyrimeve të njohura të disbalancave në marrëveshjen e re 1.1.2 - dhe pasqyrimi i detyrimeve të kontestuara në të njëjtën marrëveshje pasi të zgjidhet ligjërisht	2020Q4
1.2.3 OST-KESH	Nënshkrimi i një marrëveshje të re për zgjidhjen e detyrimeve të prapambetura për disbalancat	
2. Detyrimet e prapambetura nga njësitë publike		
2.1 Institucionet buxhetore	(i) Moduli i raportimit në thesar për detyrimet e prapambetura përfshin dhe faturat e papaguara të energjisë elektrike (ii) Udhëzimi i zbatimit të buxhetit 2021 për institucionet buxhetore përfshin pagesën e faturave të energjisë elektrike në listën e shpenzimeve prioritare (MFE)	FY2021
2.2 Ndërmarrjet e ujit	(i) Automatizimi i pagesave të faturave të energjisë elektrike përmes garancive bankare (<i>overdraft</i>): - Pilotimi në 1 - 3 ndërmarrje ujësjellësi me financa të shëndosha - Shtrirja tek ndërmarrjet e tjera që mund ta përballojnë financiarisht - Zbatimi i mekanizmit të të gjitha ndërmarrjet (ii) Fshirja/netimi i kushtëzuar i stokut të borxheve të vjetra (f) pas një performance të kënaqshme të mekanizmit të ri të pagesave	(i) Pilot: 2021 Shtrirja: 2021-23 Zbatimi i plotë bazuar në progresin e reformës së ujit (ii) 2021

	(iii) Lehtësimi i procesit të reflektimit të kostos së energjisë elektrike në tarifën e ujit në kudër të rishikimit të metodologjisë të tarifave të ujit	(iii) 2021
3. Masa të tjera		
3.1 Detyrimet tatimore	Detyrimet tatimore do të paguhën në kohë Detyrimet e prapambetura do të vazhdojnë të shlyen gradualisht (mundësisht bazuar në një plan)	2020-
3.3 Detyrimet ndaj thesarit (MFE)	(i) Përdorimi i fshirjes të detyrimeve përmes netimit ndaj ndërmarrjeve të ujit (dhe institucioneve buxhetore kur është e mundur) (ii) Shqyrtimi i një mekanizmi ristrukturimi të kësteve të prapambetura pasi rregullat e pagesave të jenë efektive.	2021-2025

4.1 Detyrimet e prapambetura të mbartura OShEE- KESh

Shumica e detyrimeve të prapambetura, 51 .4 miliardë lekë⁴ nga OShEE tek KESh dhe [9 miliardë lekë] nga OShEE në OST, janë të mbartura nga periudha e privatizimit dhe ri-nacionalizimit të ndërmarrjes së shpërndarjes [në 2015]. Marrëveshja aktuale midis OShEE dhe KESh-it, e nënshkruar në vitin 2018, parashikon shlyerjen e këtij borxhi të vjetër në këste të ndara në 29 vite. Këstet vjetore janë 2.3 miliardë lekë për 15 vitet e para dhe 1.3 miliardë për periudhën e mbetur . Ky ristrukturim u bazua në një model likuiditeti që mundësonte KESh për të paguar borxhet afatshkurtra (overdraftet) bankat tregtare. Overdraftet më vonë u zëvendësua nga një hua e BERZh që uli ndjeshëm rrezikun e rifinancimit dhe koston e borxheve afatshkurtra.

OShEE ka përsheptuar pagesën detyrimeve të vjetra të përcaktuara në marrëveshje duke ndjekur metodën FIFO duke vonuar pagesën e një pjese të faturave të reja. Kjo ka çuar në detyrime të reja shtesë përfshirë dhe kamatëvonesat që i shoqërojnë (shih Seksionin 4.3). Gjithashtu marrëveshja 2018 la jashtë detyrime dhe kamatëvonesa që nuk mund të përfshiheshin deri në momentin e nënshkrimit, të cilat duhet të rakordohen dhe pastrohen. Ndaj, lind nevoja për të rishikuar marrëveshjen aktuale për të pasqyruar të gjitha këto detyrime dhe për të shmangur gjenerimin e kamatëvonesave të tjera.

Për të siguruar një ulje të qëndrueshme të stokut të detyrimeve të prapambetura midis OShEE dhe KESh do të ndërmerren hapat e mëposhtëm:

Masat	Afati
(i) Vlerësimi i zbatimit të marrëveshjes të nënshkruar në vitin 2018 përfshirë çdo devijim nga marrëveshja e nënshkruar dhe detyrimet e lëna jashtë kësaj marrëveshjeje .	2020
(ii) Në bazë të këtij vlerësimi, do të rishikohet (dhe ri-firmoset) marrëveshja e vitit 2018 për të pasqyruar ndryshimet dhe netimin e detyrimeve të krijuar që nga kjo marrëveshje deri në fund të vitit 2019/2020.	2020
(iii) Këstet duke filluar nga viti 2021 shlyen në përputhje me marrëveshjen e nënshkruar	2021-

4.2 Detyrimet e prapambetura ndërmjet OShEE-OST

Detyrimet e papaguara të OShEE ndaj OST në vlerën 14.4 miliard lekë do të ristrukturohet duke ndjekur rregullin 105% të faturës korrente parashikuar në projektin e rimëkëmbjes të energjisë të

⁴ prej të cilave 31 miliardë lekë janë kryesore dhe 12,7 miliardë lekë janë gjobat

BB (2014). Të dy kompanitë do të punojnë për të kthyer rregullin 105% në një marrëveshje të ngjashme me atë të nënshkruar mes OShEE dhe KESH në 2018. Kjo marrëveshje e re do të përfshijë dhe detyrimet e prapambetura të akumuluar për shkak të shërbimit të balancimit prej 2.7 miliardë lekë (dhe do pasqyrojë më vonë vlerat e padakordësuara në bazë të vendimit përfundimtar të gjykatës)

Hapat që do ndiqen për uljen e detyrimeve të prapambetura mes OShEE dhe OST janë si më poshtë:

Masat	Afati
(i) Nënshkrimi i një marrëveshje e re për ristrukturimin e detyrimeve të prapambetura të akumuluar deri në 2019/20 midis OST-OSHEE	2020
(ii) Këstet shlyen në kohë në përputhje me marrëveshjen e nënshkruar	2021-

4.3 Shmangia e krijimit të detyrimeve të prapambetura të reja midis OShEE dhe KESH

Që nga koha e ristrukturimit të borxheve të vjetra në 2018, janë krijuar dhe detyrime të reja kryesisht për shkak të kontratës OSSh-KESH në kuadër të detyrimit të shërbimit publik (6.3 bn Lek nga KESH për OSHEE) dhe vonesave të pagesave të energjisë elektrike në vite të vështira si 2018 dhe kamatëvonesat që i shoqërojnë, në shumën neto prej [4.1 miliardë lekë] nga OShEE tek KESH. Kjo shumë neto përfshin dhe kamatëvonesa të detyrimeve të pazgjdhura nga marrëveshja e vitit 2018.

Politikat e ndjekura për zhvillimin e tregut shqiptar të energjisë elektrike (PRE4) zgjidhin problemin e krijimit të këtyre detyrimeve në të ardhmen. Ndërkohë, kontrata vjetore midis OShEE dhe KESH në kuadër të detyrimit të shërbimit publik do të miratojë një qasje konservatore për të shmangur akumulimin e borxheve të reja të KESH kur prodhimi i tij rezulton shumë më i ulët se parashikimet fillestare. Sa i përket borxheve të prapambetura prej 6.3 miliardë dhe 4,1 miliardë lekë, ato do të netohen/përthithen si pjesë e rishikimit të marrëveshjes të vitit 2018.

Më poshtë hapat që do ndërmerren për minimizimin e krijimit të detyrimeve të reja mes OShEE dhe KESH:

Masat	Afati
(i) Rishikimi i kontratës midis OShEE dhe KESH në kuadër të detyrimit të shërbimit publik për 2020/21 për të shmangur detyrime të reja nga pamundësia e prodhimit prej kushteve të pafavorshme të motit	2020Q3
(ii) Netimi/absorbimi i borxheve të reja të krijuara që nga nënshkrimi i marrëveshjes të 2018 si pjesë e rishikimit të kësaj marrëveshje bazuar në një akt-rakordimi mes dy kompanive.	2020Q4

4.4 Shmangia e detyrimeve ndërmjet OShEE-OST-KESH për shërbimet e balancimit

Këto janë detyrime për shkak të shërbimeve të ribalancimit dhe balancimit të ofruara nga KESH tek OST. OST praktikisht transferon direkt detyrimet e papaguar për disbalancat nga OSHEE tek KESH. Për OSHEE ky shpenzim/detyrim i shtuar ka ardhur pas transferimit të prodhimit të IPP nga KESH tek OSHEE si pjesë e ristrukturimit të tregut dhe optimizimit të ulët të disbalancave edhe për shkak të paparashikueshmërisë të fluksit të IPP.

Në 2020 OShEE ka përmirësuar ndjeshëm parashikimin e një dite përpara duke ulur disbalancat në nivele që janë të përballueshme për t'u paguar . Rifillimi i pagesës së shërbimit të ribalancimit për vitin 2020 është hapi i parë i rëndësishëm në parandalimin e akumulimit të mëtejshëm të borxheve nga ky funksion i ri i tregut.

Stoku i borxheve të akumuluar për këtë shërbim, do të jetë pjesë e marrëveshjes së re midis OSHEE dhe OST dhe marrëveshjes tjetër të ngjashme mes OST dhe KESH (4.4 miliard lekë) për të njëjtën kategori detyrimesh të prapambetura (seksioni 2.3). Për të siguruar pagesa në kohë reale ndërmjet OSHEE, OST dhe KESH më vonë do të konsiderohet dhe mundësia e garancive bankare në ndërmjetësimin e pagesave.

Hapat që do të ndiqen për të eliminuar këtë kategori detyrimesh të prapambetura janë si më poshtë:

Masat	Afati
(i) Faturat për disbalancat paguhen në kohë	2020-
(ii) Zbatimi i garancive bankare për pagesat e disbalancave	2021

Rezultati i pritshëm nga këto masa është mos krijimi i asnjë borxhi të ri për shkak të shërbimeve të ribalancimit.

4.5 Detyrimet e prapambetura nga njësitë e sektorit publik

Ndërmarrjet e ujësjellësit përbëjnë burimin kryesor të borxheve të prapambetura nga sektori publik ndaj OSHEE. Ndërkohë që ka dhe institucionet të tjera buxhetore dhe jo-buxhetore që krijojnë detyrime të prapambetura megjithëse në vlera më të vogla. Nga ana tjetër, kompanitë e energjisë elektrike e transferojnë pjesën më të madhe të kësaj barre në thesar duke mos arritur shlyerjen në kohë të kredive koncesionare për investime në sektorin e energjisë. Në këtë seksion, listohen masat për trajtimin dhe eliminimin e këtyre detyrimeve të prapambetura.

Ndërmarrjet e ujësjellësit

Pas një fshirje të konsiderueshme të detyrimeve të prapambetura të akumuluar midis ndërmarrjeve të ujit dhe ndërmarrjeve të energjisë elektrike (netim) në vitin 2014, detyrimet e prapambetura nga ndërmarrjet e ujit janë rritur në të njëjtin nivel të para-fshirjes, mbi 10 miliardë lekë pa kamatëvonesë (mbi 17 miliard lekë në total). Reforma e sektorit të ujit synon përmirësimin e gjendjes financiare të ndërmarrjeve të ujit që duhet të ndihmojë dhe për kryerjen e pagesave në kohë të faturave të energjisë. Ndërkohë, do të shtohet fokusi tek ato ndërmarrje të ujësjellësit që kanë arritur një performancë financiare të kënaqshme për të përballuar mbulimin e faturave të tyre, përfshirë dhe energjinë elektrike pa subvencione. Kjo do të përmirësojë nivelin e arkëtimit të energjisë elektrike nga sektori i ujit në të paktën 75% duke zbutur varësinë e sektorit të energjisë nga progresi i reformës së ujit në një nivel të përballueshëm deri në finalizimin e plotë të reformës.

Për të siguruar pagesat e rregullta të energjisë elektrike ato fillimisht do të trajtohen si një tregues performance kyç i reformës së ujit. Por jo vetëm. Ndryshe nga eksperiencia e mëparshme e fshirjes të detyrimeve të prapambetura, në këtë plan masash është parashikuar përdorimi i instrumente të rinj financiar për të garantuar pagesat e energjisë elektrike në kohë. Këto instrumente konsistojnë në marrëveshje debitimi direkt midis ndërmarrjeve të ujit dhe OSHEE/FShU të garantuara nga overdrafte/linja kredie bankare, nëse është nevoja dhe me mbështetjen e qeverive vendore, bazuar në rregullat e forcimit të financave publike.

Skema e garancisë të pagesave do të pilotohen fillimisht në 1 deri 3 ndërmarrje ujësjellësi me financa të shëndosha në gjendje për të përballuar kostot e energjisë elektrike. Pas pilotimit dhe vënien në funksion të këtyre instrumenteve, ata do të shtrihen në 5 kompanitë më të mëdha të ujit kompanive (2021/22) që kanë 62% të borxheve ndaj sektorit të energjisë dhe më pas për 10 më të

mëdhatë (2022/23) që gjenerojnë 80% të detyrimet e prapambetura. Zbatim të suksesshëm të këtij instrumenti për çdo ndërmarrje mund të ndiqet nga fshirja e borxheve të akumuluar të saj, të ngjashëm me netimin e vitit 2014, në rast se kompanitë tregojnë performancë të kënaqshme për mos-krijimin e detyrimeve të reja.

Në këtë proces do të bëhen përpjekje dhe për rishikimin e metodologjisë tarifave të ujit që do të lehtësonte dhe përshpejtonte miratimin e pasqyrimin e kostos të energjisë elektrike në tarifën e furnizimit me ujë.

Më poshtë përmbledhen masat që do ndërmerren në lidhje me forcimin e disiplinës së pagesës së energjisë elektrike nga ndërmarrjet e ujësjellësit

Masat	Afati
(i) Identifikimi i disa ndërmarrjeve të ujit që mund të përballojnë të mbulimin e faturës të energjisë elektrike	2020
(ii) Automatizimi/garantimi i pagesës për faturat e energjisë elektrike përmes debitimit direkt - Pilot 1-3 ndërmarrje	2021
(iii) Shtrirja e instrumentit të ndërmarrjet e tjera të ujit (top 5 dhe top 10 ndërmarrje)	2021-23
(iv) Neto-stok i stokut të borxheve bazuar në një performancë të kënaqshme të mekanizmit të ri të pagesave	2021-23
(v) Lehtësimi i ndërmarrjeve të ujit për të pasqyruar përbërësin e energjisë elektrike në tarifën e tyre duke përfshirë dispozita specifike në metodologjinë e ardhshme të tarifave të ujit (ERU)	2021

Detyrimet nga institucionet buxhetore

Faturat e papaguara të energjisë elektrike nga institucionet buxhetore nuk janë aq të larta sa ato të sektorit të ujit. Por ky është një fenomen që duhet të eliminohet për rrezikun e reputacionit që ai mbart për ruajtjen e disiplinës të pagesës të energjisë elektrike nga publiku i gjerë. Ka pasur përpjekje të vazhdueshme duke ushtruar presionin mbi institucionet publike për të paguar faturat e energjisë elektrike. Udhëzimet e buxhetit i përfshijnë faturat e energjisë elektrike në listën prioritare edhe në rast likuiditeti të kufizuar. Udhëzimet e reja të buxhetit do të përfshijnë kërkesa shtesë për të përcaktuar përparësitë pagesën e detyrimeve të prapambetura para çdo pagese tjetër (ku faturat e energjisë elektrike do të jenë pjesë e listës të prioriteteve). Kontrolli i detyrimeve të prapambetura do të jetë pjesë e strategjisë më të gjerë të parandalimit të detyrimeve të prapambetura nga MFE. Në këtë kuadër një hap i parë është ngritja e një moduli për raportimin automatik të detyrimeve të prapambetura në thesar, përfshi këtu dhe faturat e energjisë elektrike.

Në lidhje me shlyerjen e kredive koncesionare të sektorit të energjisë, që janë të garantuara dhe të paguar nga thesari do të vlerësohet një ristrukturim i mundshëm, pasi disiplina e pagesave në sektorin të jetë stabilizuar sipas hapave të këtij plan-veprimi. Vlerësimi do të bazohet në një analizë financiare afatgjatë të secilës prej kompanive veçanërisht KESH dhe OST që kanë pjesën më të madhe të kredive koncesionare për t'u ripaguar.

Hapat e ardhshëm:

Masat	Afati
(i) Udhëzimi i zbatimit të buxhetit 2021 për institucionet buxhetore përfshin pagesën e faturave të energjisë elektrike në listën e shpenzimeve prioritare (MFE);	2020/21

(ii) Moduli i raportimit në thesar për detyrimet e prapambetura përfshin dhe faturat e papaguara të energjisë elektrike	2021
(iii) Shqyrtimi i një mekanizmi ristrukturimi të kësteve të prapambetura pasi rregullat e pagesave të jenë efektive, dhe zbatimit të netimit ndaj ndërmarrjeve të ujit/energjisë	2023-

Detyrimet tatimore

Detyrimet e prapambetura tatimore kanë ardhur në ulje. Të gjitha kompanitë e energjisë elektrike kanë paguar në kohë detyrimet vjetore duke paguar një pjesë të detyrimit prapambetur. Me përmirësimin e disiplinës së pagesës nga njësitë e tjera publike, pastrimi i detyrimeve të papaguara (të vjetra) do të përshpejtohet, duke vazhduar pagesën në kohë të detyrimeve korrente.

Hapat në vazhdim:

Masat	Afati
Detyrimet tatimore vjetore do të paguhën në kohë dhe do të vazhdojë ulja graduale (e planifikuar) e borxheve ndaj tatimeve.	2021-

5. Rezultatet e pritura të planit të veprimit

Zbatimi i këtij plani veprimi duhet të japi rezultate konkrete që në vitin 2020 dhe 2021. Rezultatet do të jenë më të dukshme pas zbatimit të mundshëm të fshirjes/netimit të detyrimeve të sektorit të ujit dhe sektorit të energjisë me thesarin deri në vitin 2025. Tabela 3 ilustron rezultatet e pritshme që do të shërbejnë si tregues performance në bazë të pritshmërisë dhe supozimeve të mëposhtme:

- (i) Nga viti 2021 në vazhdim këstet për marrëveshjen dypalëshe të nënshkruar mes kompanive të energjisë elektrike do të ekzekutohen rregullisht çdo vit: (a) OShEE 2.3 miliard lekë ndaj KESH; OShEE 0.5 miliard lekë ndaj OST dhe OST 100 milion lekë ndaj KESH; duke ulur gradualisht stokun e detyrimeve të prapambetura mes kompanive
- (ii) Do të shmanget krijimi i borxheve të reja mes kompanive të energjisë (b, c, e).
- (iii) Detyrimet e prapambetura të ndërmarrjeve të ujit (w) nuk pritet të përmirësohen përpara vendosjes të mekanizmave të rinj të pagesës së energjisë.
- (iv) Në vitin 2021 përveç uljes të stokut të detyrimeve të papaguar të OShEE-KESH (a) është reflektuar dhe netimi/përthithja e borxheve të reja ndërmjet kompanive (b, c) në marrëveshjen aktuale të rishikuar
- (v) Duke filluar nga viti 2022 detyrimet e prapambetura nga ndërmarrjet e ujësjellësit pritet të shohin një përmirësim me aktivizimin mekanizmit të pagesave me garanci bankare dhe netimit të borxheve të papaguara (f). Supozimi/objektivi është arritja e një reduktimi të detyrimit të prapambetura me rreth 2mld në vit. Kjo do reflektohet dhe te borxhet respektive të *Ujësjellës ndaj OShEE/FShU ndaj KESH ndaj MF*
- (vi) Detyrimet e prapambetura ndaj tatimeve (t) dhe te institucioneve buxhetore (g) gjithashtu pritet të ulen gradualisht

Në vitin 2025, detyrimet e prapambetura parashikohet të reduktohen mbi 30 miliard lekë. Ky parashikim mbart dhe rreziqe. Një prej rreziqeve kryesore është progresi i reformës së ujit. Një reformë më e ngadaltë do ta ulte ndjeshëm hapësirën për netimin e borxheve të ndërsjella. Kompanitë e energjisë elektrike, gjithashtu, mund të akumulojnë sërish borxhe të ndërsjella mes tyre. MFE dhe MIE do të monitorojnë rregullisht zbatimin e këtij plani veprimi në kuadër të reformës së sektorit të energjisë dhe do të marrin masat e nevojshme korrigjuese sipas zhvillimeve.

Tabela 3: Rezultatet e pritshme (miliardë Lekë)

2020							2021						
	KESh	OST	OShEE	MFE	Tax	Total		KESh	OST	OShEE	MFE	Tax	Total
KESh ndaj:		?	-	14.9	0.89		KESh to:		-	-	15	0.5	
OST:	4.4		0.81	11.1	=		OST to:	4		-	12	=	
OShEE:	50.1	14.4		4.5	5		OShEE to:	48	13		5	4.5	
Water U.			18				Water U.			17.5			
Budget I.			3.7				Budget I.			3			
Total							Total						
2022							2023						
	KESh	OST	OShEE	MFE	Tax	Total		KESh	OST	OShEE	MFE	Tax	Total
KESh ndaj:		=	=	14	=		KESh to:		=	=	10	=	
OST:	3.8		=	12	=		OST to:	3.6		=	11.5	=	
OShEE:	44	12.5		5	4		OShEE to:	40	12		4.5	3.5	
Water U.			15				Water U.			12			
Budget I.			2				Budget I.			1			
Total							Total						
2024							2025						
	KESh	OST	OShEE	MFE	Tax	Total		KESh	OST	OShEE	MFE	Tax	Total
KESh to:		=	=	6	=		KESh to:		=	=	1	=	
OST to:	3.4		=	11	=		OST to:	3.2		=	10	=	
OShEE to:	35	11.5		4	3		OShEE to:	30	11		3.5	2.5	
Water U.			8				Water U.			4			
Budget I.			-				Budget I.			=			
Total							Total						

Figura 2: Rezultatet e pritshme.

